

L I G J
Nr.7898, datë 2.2.1995

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7581, DATË 7.7.1992 “PËR ÇMIMET DHE
TARIFAT”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 4 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat”, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përfshihet caktimi i emërtesës dhe i kufijve maksimalë për tarifat e shërbimeve portuale dhe aeroportuale bëhet nga Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Feltoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1020, datë 14.2.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha